



**Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të  
Fëmijëve në Shqipëri**

**Mbrojtja Ndërkombëtare e Fëmijëve  
CRCA / DCI Shqipëri**

# MANUAL

**Trainimi për Partitë dhe Forumet Politike në Shqipëri**

**Përgatitur nga:**

**Etleva BISHA**

## **PERMBAJTJA**

### **HYRJE**

**FQ. 3**

### **PJESA E PARE**

#### **SISTEMI POLITIK I DEMOKRACISË LIBERALE**

**FQ. 4-12**

Përmbledhje  
Demokracia  
Ideologjia  
Demokracia liberale  
Partitë politike  
Sistemet partiake  
Spektri partiak  
Sistemi Elektorale  
Grupet e interesit si kontribues të demokracisë  
Workshop I: Gratë dhe të rinjtë në vendimarrjet lokale

### **PJESA E DYTE**

#### **ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE**

**FQ. 13 - 25**

Përmbledhje  
Vlera e partive politike  
Çfarë e bën demokratike një parti politike?  
Statuti  
Workshop 2: Përzgjedhja e kandidatëve të forcës politike për funksione publike  
Platforma politike  
Komunikimi  
Workshop 3: Komunikimi i brendshëm dhe marrja e vendimeve demokratike  
Gjetja e fondeve  
Workshop 4: Fund raising

### **PJESA E TRETË**

#### **FUSHATA ELEKTORALE**

**FQ. 26 - 37**

Hyrje  
Roli dhe rëndësia e fushatave elektorale  
Konceptimi i fushatave elektorale  
Strategjia e fushatës  
Planifikimi i fushatës.  
Realizimi i fushatës  
Workshop 5: Konferenca e shtypit  
Workshop 6: Axhenda politike dhe mesazhi

## HYRJE

Manuali i Trainimit për Partitë dhe Forumet Politike në Shqipëri u përgatit nga CRCA/ DCI Shqipëri me qëllim që ti vijë në ndihmë Partive Politike në Shqipëri, si dhe Forumeve politike të Grave dhe të Rinjve për të plotësuar nevojat për informacion apo trainim të anëtarëve apo vullnetarëve të angazhuar pranë tyre.

Në funksion të nevojave për informacion që ndeshen rëndom në partië politike në Shqipëri, Manuali është hartuar me tre pjesë kryesore:

Pjesa e parë e Manualit fokusohet tek konceptet bazë mbi sistemin politik të demokracisë liberale, duke i parë ato jo vetëm nga pikpamja teorike, por duke u përpjekur të stimulojë gjithashtu elementë praktikë të nevojshëm për të gjithë ata që janë të angazhuar në parti apo forume politike. Workshopi, pjesë integrale e kësaj pjese të parë të Manualit plotëson këtë synim.

Pjesa e dytë e Manualit fokusohet tek Organizimi i Partive Politike duke u përpjekur të sjellë praktikat më pozitive në këtë këndvështrim. Disa workshope të përfshira në këtë pjesë sërish synojnë të plotësojnë komponenten praktike të njohurive të ofruara nga manuali.

Në pjesën e tretë Manuali jep informacion të gjerë mbi mënyrën e konceptimit, përgatitjes dhe realizimit të fushatave elektorale. Janë dy workshope të prezantuara në këtë pjesë të Manualit, të cilat pajisin praktikisht personat e interesuar me elementë specifik të fushatave elektorale.

Manuali u përgatit nga znj. Etleva Bisha, Master në Studime Europiane dhe eksperte e jashtme pranë CRCA/DCI Shqipëri. Znj. Bisha ka njohuri të thelluara në fushat e menaxhimit dhe drejtimit të partive politike, marrëdhënieve me publikun, politikave të sigurisë etj. Ajo bashkëpunon prej vitesh me CRCA/DCI Shqipëri dhe OJF të tjera si trainere mbi fuqizimin e rolit të gruas në partitë politike dhe rritjen e pjesëmarrjes së saj në vendim-marrje. Është bashkë-autore në disa Manuale të përgatitura nga CRCA/DCI Shqipëri. Po ashtu ajo është autore e një sërë studimesh mbi pjesëmarrjen e grave në zgjedhje dhe në politikë.

## PJESA E PARE

### SISTEMI POLITIK I DEMOKRACISË LIBERALE

#### PËRMBLEDHJE

Qëllimi i kësaj pjese të Manualit konsiston në dhënien e disa prej koncepteve bazë që iu ndihmon Ju, si staf i angazhuar në një parti politike, të përmirësoni apo pasuroni njohuritë tuaja në lidhje me Sistemin Politik të Demokracisë Liberale, sistem që pas viteve '90 u institucionalizua edhe në Shqipëri. Në fokus të tij janë Demokracia dhe kuptimet e saj, tiparet themelore të Demokracisë Liberale, koncepte që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me Partitë Politike, Sistemin Elektoral si një nga komponentët më të rëndësishëm të Sistemit Politik të Demokracisë Liberale, lidhja e tij me sistemin partiak dhe Kabinetin Qeveritar, Grupet e Interesit dhe kontributi i tyre për demokracinë.

#### I. DEMOKRACIA

“Demokracia” si fjalë e ka prejardhjen nga greqishtja: demons-popull dhe kratia-pushtet. E konceptuar kështu ajo nënkupton **qeverisje nga populli**. Ndërkohë **demokracia** mund të jetë e **drejtpërdrejtë** ose **përfaqësuese**.

Demokracia e drejtpërdrejtë nënkupton që të gjithë shtetasit (apo pjesëtarët e një komuniteti të caktuar) kanë të drejtën të marrin pjesë në diskutimet dhe në vendimarrjet që ndikojnë drejtpërdrejt mbi jetën e tyre. Kjo lloj demokracie kuptohet që është e zbatueshme kur numri i shtetasve apo i komunitetit është i vogël (gjë që u jep mundësinë të gjithëve të përfshihen në vendimarrje)

Por, kur numri i popullsisë është i madh atëherë ata zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të cilët marrin vendime dhe miratojnë ligje në emrin e tyre. Kjo formë e demokracisë njihet si **demokrati përfaqësuese**.

Studiues të ndryshëm japin përkufizime të ndryshme për demokracinë. Por nëse i referohemi një shteti demokratik, përkufizimi më i përshtatshëm do të ishte:

“Demokracia ekziston kur marrëdhëniet midis të qeverisurve dhe qeverisë i përmbahen parimit se **shteti është në shërbim të qytetarëve** dhe jo anasjelltas, se **qeveria ekziston për popullin**, dhe jo anasjelltas.”

Pranohet gjerësisht se në një sistem demokratik, Demokracia mund të përmblihet ne:

- zgjedhje të përgjithshme të lira
- liri e organizimit
- liria e fjalës dhe e shtypit
- liria e opinionit
- barazi përpara ligjit

**Egzistenca e demokracisë së brendshme në një parti politike është një parakusht për respektimin e demokracisë edhe në qeverisjen e vendit.** Tek partitë politike gjejmë të zbatuar të dyja tipet e demokracisë: si demokracinë përfaqësuese, ashtu edhe atë të drejtpërdrejtë.

Në shumicën e vendimarrjeve brenda forcës politike ushtrohet demokracia përfaqësuese, pra anëtarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në nivele drejtuese brenda forcës politike, të cilët marrin vendime të mandatuar nga anëtarët.

Ndërkohë demokracia e drejtpërdrejtë (shpjegimin e së cilës e pamë më lart) gjen zbatim për rastet kur vendimarrjet janë të tilla që kërkojnë vendimin e vetë anëtarëve (pa mandatuar të tjerë). Parimi “Një anëtar, Një Votë” nënkupton zbatimin e demokracisë së drejtpërdrejtë në një parti politike.

## **II. IDEOLOGJIA**

Ideologjia është një term politik, që në thelb përmban mënyrën se si shohim të tashmen dhe vizioni që kemi për të ardhmen. E ardhmja prezantohet si një përmirësim material i së tashmes, gjë që i jep ideologjisë një karakteristikë të rëndësishme: **ideologjia ofron shpresën.**

Ndërkohë ideologjia **shoqërohet me një plan-veprimi.** Ajo jo vetëm shpjegon realitetin, por edhe jep drejtime të caktuara mbi hapat që duhet të ndërmerren për të përmbushur objektivin e saj.

Ideologjia **ka si target njerëzit.** Ajo synon të nxisë mobilizimin e sa më shumë njerëzve e për rrjedhojë gjuha që përdor është e thjeshtë për të arritur të kuptohet nga të gjithë.

### III. DEMOKRACIA LIBERALE

Demokracia liberale është një formë qeverisje, **është sistem politik**. Sipas Fred H. Will Hoite (“Power and Government”) tiparet themelore të saj janë:

1. Egzistenca e Kushtetutës, e cila në thelb ndalon qeverinë të abuzojë me pushtetin. **Ndarje e tre pushteteve: Legjislativ** (Parlamenti), **Egzekutiv** (Qeveria) dhe **Juridik** (Gjyqësori). Ndarja e pushteteve e bën të pamundur që njëra prej tyre të marrë aq pushtet sa që të dominojë mbi të tjerat. Secili prej pushteteve ka kompetencat e veta të qarta, por egzistojnë mekanizma që sigurojnë kontrollin dhe balancën mes tyre.
2. **Qeverisje përfaqësuese e përgjegjshme dhe llogaridhënëse**: thelbi qëndron në demokracinë elektorale, e cila u krijon mundësinë votuesve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre. Ndërkohë vendoset një lidhje mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve dhe trysnia elektorale është e tillë që nxit përgjegjshmërinë e të zgjedhurve, si dhe llogaridhënien e tyre tek zgjedhësit.
3. **Pluralizmi partiak**: nënkupton egzistencën e shumë partive politike e për rrjedhojë nxit konkurrencën, i ofron alternativa të shumëllojta zgjidhjesh elektoratit, produkt i së cilës janë politikat më të përgjegjshme dhe frytëdhënësve që i shërbejnë elektoratit.
4. **“Sundim i shumicës duke respektuar pakicën”** që nënkupton raportin mes shumicës parlamentare dhe partive në opozitë. Opozita është instrument për të kontrolluar përmbushjet e detyrave nga shumica.
5. **Egzistenca e grupeve të interesit**: të cilat sigurojnë mbrojtjen e interesave të grupeve të ndryshme të shoqërisë.
6. Liria për **pjesëmarrje në politika**.
7. **Ndryshimet paqësore**. Ndryshimet vijnë përmes alternativave, ideve që kanalizohen në partitë e ndryshme politike të cilat të mandatuar nga vota e zgjedhësve realizojnë ndryshimet e kërkuara.

### IV. PARTITË POLITIKE

Partitë politike janë **pjesë e rëndësishme e demokracisë liberale**. Ndryshe nga grupet e interesit ato nuk përfaqësojnë vetëm një sektor të caktuar të politikave. Së bashku me votuesit, partitë dhe të zgjedhurit e tyre janë **aktorët kryesorë në shumicën e procedurave bazë që përbëjnë thelbin e demokracisë**: zgjedhjen e legjislativit dhe (drejtpërdrejt apo indirekt) të qeverisë. Në sistemet demokratike

partitë politike janë **ndërmjetësit thelbësorë mes votuesve e interesave të tyre** nga njëra anë **dhe institucioneve vendimarrëse** nga ana tjetër.

Partia Politike është një organizim politik që duke marrë pjesë në fushatat elektorale synon të fitojë pushtet politik përmes qeverisjes së vendit. Në fakt egzistojnë përkufizime të ndryshme mbi partitë politike, përkufizime që nxjerrin në pah dimensione të ndryshme të rolit dhe funksionit të tyre në shoqëritë demokratike.

Crotty, për shembull, i përkufizon: “Një parti politike është një grup i organizuar i ligjshëm që përmbush funksionet e edukimit të publikut në drejtim të pranimin të sistemit politik si dhe të efektit të politikave, që rekruton dhe promovon individë për në funksione publike dhe që siguron një lidhje të gjerë mes publikut dhe vendimarrësve.” Ky përkufizim nxjerr në pah tre nga rolet që luajnë partitë politike në një shoqëri demokratike: **edukim; promovim individësh që marrin përsipër funksione publike; sigurimi i lidhjes mes publikut dhe vendimarrësve;**

Në sistemin politik të demokracisë liberale partitë politike kryejnë dy **funksione** kryesore:

1. Partitë politike janë urë **lidhëse mes elektoratit masiv dhe parlamentit**, i cili në demokracinë liberale është “organ përfaqësues”.

Janë partitë politike që në zgjedhjet e përgjithshme i paraqesin elektoratit kandidatët e tyre për të qenë zëdhënësit e këtij elektorati në parlament. Ndërkohë që partitë politike përgatisin edhe politikanët pjestarë të kabinetit qeveritar apo niveleve të tjera të vendimarrjeve të rëndësishme. Pra janë partitë politike ato që realizojnë “**qeverisjen përfaqësuese**” që siç e pamë është karakteristike për natyrën e sistemit të demokracisë liberale.

2. Përmes alternativës së tyre, **Programit Elektorale**, të formuluar mbi bazën e njohjes së kërkesave dhe nevojave të publikut, ato i **ofrojnë zgjedhësve zgjidhjet** e tyre, që në thelb sigurojnë zhvillim ekonomik dhe social. Në përpjekjen për të siguruar mbështetjen e elektoratit në garat elektorale dhe në kushtet e egzistencës së shumë partive politike ku secila ofron zgjidhjet e veta, partitë politike harmonizojnë kërkesat dhe interesat e sa më shumë grupeve sociale të shoqërisë, duke sjellë si rezultat qeverisje efektive.

## 1. Sistemet Partiake

### ⇒ Sistemi njëpartiak

Në këtë sistem vetëm një parti politike lejohet për të ushtruar pushtet. Edhe pse ndonjëherë lejohen të egzistojnë parti të vogla, atyre u kërkohet me ligj që të pranojnë drejtimin e partisë dominuese. Kjo parti ndonjëherë nuk është e njëjtë me qeverinë, edhe pse shpesh pozicionet brenda partisë mund të jenë më të rëndësishme se pozicionet në qeveri. Shembull i këtij sistemi partiak është sot Kina. Autoritarizmi dhe korrupsioni janë dy nga fenomenet që shoqërojnë këtë sistem partiak.

### ⇒ Sistemi i Partisë Dominuese:

Sistemi krijon mundësinë që të lejohen partitë opozitare madje mund të egzistojë edhe një traditë demokratike, por partitë e tjera konsiderohen gjerësisht se nuk kanë shanse për të fituar pushtet. Shpesh rrethanat politike, sociale dhe ekonomike dhe opinionin publik janë arsyeja e dështimit të partive të tjera. Shembull është Partia Liberaldemokrate në Japoni. Problemet që shoqërojnë këtë tendencë janë vetëkënaqësia, arroganca në ushtrimin e pushtetit dhe korrupsioni.

### ⇒ Sistemet dypartiake

Ky është rasti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku ka dy parti politike që dominojnë aq shumë, sa që sukcesi elektoral i ndonjë partie tjetër është jashtëzakonisht i vështirë. Është natyra e sistemit elektoral që në shumicën e rasteve çon në sistemin dypartiak. Problemi që shoqëron këtë sistem lidhet me egzistencën e mundësisë për të reduktuar dhe penguar zgjidhjet e tjera alternative që mund ti jepeshin elektoratit nga partitë e tjera

### ⇒ Sistemi Shumëpartiak

Janë sistemet në të cilat konkurentë të mundshëm për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit janë më shumë se sa dy parti. Në këto sisteme është përgjithësisht e zakonshme që asnjë prej partive të mos arrijë të marrë mbështetjen e mjaftueshme nga elektorati për të qeverisur e vetme dhe për rrjedhojë kabinetet qeveritare në shumicën e rasteve janë kabinete koalicionesh partiake.

## 2. Spektri Partiak

Është një term që përdoret për të treguar **orientimet e partive politike**: orientimet nga e majta, e djathta, qendra, ekstremi i majtë, ekstremi i djathtë. Spektri partiak në thelb njeh dallimet që egzistojnë midis partive politike të ndryshme, **dallime** që



**përmbliidhen në tërësinë e ideve që partitë e ndryshme kanë mbi mënyrën se si funksionon dhe se si duhet të funksionojë më mirë shoqëria demokratike.**

Në sistemet dypartiake dallimet mes partive politike në thelb janë dallime mes të majtës dhe të djathtës (modeli britanik) dhe kryesisht lidhen me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në sistemet shumëpartiake dallimet mes partive politike janë shumëpërmasore:

- Për problemet social-ekonomike
- Dallime etniko-kulturore
- Dallime mes zonave rurale dhe urbane
- Baza klerikale-antifetare
- Formën e rregjimit (mbizotërim i Parlemanetit, egzekutivit)
- Për politikën e jashtme etj.

Ndërkohë për të kuptuar dallimin mes të majtës dhe të djathtës mund të marrin si shembull pozicionet e tyre kundrejt politikave ekonomike dhe sociale në periudhën 1945-1980, të cilat sipas Lijphart janë:

### **E majta**

1. I jepte përparësi pronësisë publike, krahas pronësisë private mbi mjetet e prodhimit dhe të shpërndarjes
2. Kërkonte rol më të madh të qeverive në drejtimin dhe planifikimin e ekonomisë.
3. Politikë më të efektshme për realizimin e shpërndarjes së pasurisë nga njëri segment i shoqërisë në tjetrin.
4. Zgjerim të programeve qeveritare në kuadrin e Shtetit të Mirëqënies Sociale.

### **E djathta**

1. Ishte për rol mbizotërues të pronësisë private në ekonomi
2. Rol sa më të vogël të qeverisë në drejtimin dhe planifikimin e ekonomisë.
3. Rishpërndarje e kufizuar e të ardhurave
4. Minimizim të programeve qeveritare në kuadrin e shtetit të Mirëqënies Sociale.

## **V. SISTEMI ELEKTORAL**

Në Evropën perëndimore sot egzistojnë modele të ndryshme të sistemeve elektorale, të cilat mund të përmbliidhen në:

- a. mazhoritar i pastër: nënkupton që parlamenti kompozohet nga deputetët (të caktuar në zonat zgjedhore nga partitë politike) që zgjidhen drejtpërdrejt nga vota e zgjedhësve.
- b. Proporcional. Ka disa modele të zbatimit të tipit proporcional:
  - Proporcional rajonal me listë të mbyllur: çdo parti konkuron mbi bazë rajonesh për një numër vendesh në parlament. Lista e deputetëve për çdo rajon hartohet nga forca politike respektive (procedurat e përzgjedhjes variojnë në forca të ndryshme politike). Zgjedhësit votojnë për forcën politike që preferojnë dhe përqindja që merr çdo parti në garë kthehet në numër vendesh në parlament, sipas një formule për llogaritjen e vendeve.
  - Vota e vetme, por e transferueshme: në listë është emri i partisë dhe ai i kandidatit. Psh. Kandidatit i duhen 2000 vota për të fituar, por në fakt ka fituar 2150 vota, në këtë rast 150 vota i transferohen partisë.
  - Ndërthurje e modelit mazhoritar dhe i modelit proporcional: Gjermania 50% e vendeve vijnë nga zgjedhjet e kandidatëve të drejtpërdrejtë dhe 50% e vendeve nga lista partiake.
  - Shumica absolute: (50%+1): model që kërkon tur të dytë, ku hyjnë sërish në garë ata që kanë marrë mbi 12% të votave në turin e parë. Ky model shoqërohet me pragun elektoral, i cili në vendet e BE varion: 0,6% - 5%

### **Lidhja e Sistemit Elektoral me Sistemin Partiak dhe tipin e Kabinetit Qeveritar**

Sistemi elektoral është një element i rëndësishëm i sistemit politik, i cili është ngushtësisht i lidhur me sistemin partiak. Në fakt janë dy elementë që realisht ndikojnë tek njëri-tjetri.

Marrim shembullin e Britanisë së Madhe: Janë dy parti politike më të mëdha në Britani, konkretisht Laburistët (të majtë) dhe Konservatorët (të djathtë).

Sistemi elektoral është i tipit pluralist i shumicës së thjeshtë, që do të thotë se nga kandidatët e rregjistruar (përfaqësues të partive Politike) në çdo zonë elektorale fiton ai që merr më shumë vota në raundin e parë dhe të vetëm. Kjo padyshim që

favorizon dy partitë më të mëdha që kanë mbështetjen më të madhe të zgjedhësve. Për rrjedhojë sistemi elektoral krijon shumicë njëpartiake në parlament. Partia që ka marrë shumicën e deputetëve të drejtpërdrejtë kuptohet që përbën shumicën në Parlament dhe ajo e vetme mund të krijojë kabinetin qeveritar dhe të zbatojë atë program që i ka paraqitur zgjedhësve gjatë fushatës. Pra qeveritë në modelin britanik janë njëpartiake.

Ndërkohë në shtetet që kanë sistem shumëpartiak, sistemi elektoral është i tillë që synon të sigurojë përfaqësimin në Parlamantet të sa më shumë partive politike. Sistemi elektoral është i tipit proporcional, që nënkupton se partitë politike fitojnë një numër vendesh në Parlament në mënyrë proporcionale me përqindjen e votave të fituara. Përfshirja në parlament e një numëri të madh partish politike, ku është shumë e vështirë të ndodhë që vetëm njëra të ketë numrin e mjaftueshëm të vendeve në Parlament që do ta bënte të aftë të krijonte kabinetin qeveritar e vetme, bën që partitë parlamentare të ndërtojnë koalicione me qëllim formimin e kabinetit qeveritar. Pra është sistemi elektoral që favorizon përfaqësim shumëpartiak në parlament dhe qeverisje të gjerë mbi bazë koalicionesh.

## **VI. GRUPET E INTERESIT SI KONTRIBUES TË DEMOKRACISË**

Grupet e interesit janë produkt i lirisë së krijimit të shoqatave, që është parim bazë i demokracisë liberale. Ndryshe nga partitë politike ato nuk kanë interes qeverisjen e vendit. Ato shërbejnë si ndërmjetës mes qeverisë dhe shoqërisë, **ndihmojnë në shpërndarjen e pushtetit politik** dhe janë njëkohësisht **kundërpeshë për të balancuar përqëndrimin e pushtetit.**

Partitë politike nuk mund të sigurojnë përfaqësimin e plotë në gamën e gjerë të interesave dhe opinionëve të ndryshme në demokracinë moderne. Grupet e interesit bëjnë të mundur që të dëgjohen interesat të veçanta dhe çështje të veçanta dhe të ndikojnë në marrjen e vendimeve për këto çështje.

Ato ndihmojnë në kapërcimin e defiçitit demokratik, i krijuar për shkak të faktit që pjesëmarrja e popullit në politikë vjen përmes votës një herë në katër vjet, pra zgjedhësit kanë pak mundësi të ndikojnë mbi vendimarrjet në periudhën mes zgjedhjeve. Grupet e interesit ndihmojnë në zvogëlimin e këtij defiçiti. Në të njëjtën kohë ato përmirësojnë cilësinë e qeverisjes duke mundësuar hyrjen në axhendën e politikës së çështjeve të reja, p.sh gratë, mjedisi etj.

## WORKSHOP I

### GRATË DHE TË RINJTË NË VENDIMARRJET LOKALE

#### **Grupi A:**

Ju jeni anëtar i Njësisë Drejtuese të Forumit Rinor të njëjës prej Bashkive kryesore në vend. Sot jeni mbledhur për të diskutuar dhe hartuar projektin e Forumit tuaj lokal për vitin e ardhshëm.

Ju duhet të planifikoni aktivitete që **nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjet lokale.**

#### **Grupi B:**

Ju jeni anëtare e Njësisë Drejtuese të Forumit të Gruas të njëjës prej Bashkive kryesore në vend. Sot jeni mbledhur për të diskutuar dhe hartuar projektin e Forumit tuaj lokal për vitin e ardhshëm.

Ju duhet të planifikoni aktivitete që **nxisin pjesëmarrjen e grave në vendimarrjet lokale.**

## **PJESA E DYTE:**

### **ORGANIZIMI I PARTIVE POLITIKE**

#### **PËRMBLEDHJE**

*Partitë politike nuk duhet të shpenzojnë më shumë energji gjatë fushatave elektorale se sa në periudhën midis tyre. Një parti që gjithnjë punon, pavarësisht nga fushatat, arrin ti përmbushë më lehtë objektivat e e saj në kohë fushate.*

Në tërësi drejtuesit e një partie politike mbeten gjithnjë të angazhuar për të përmbushur jo vetëm angazhimet publike, që si përfaqësues të forcës politike kanë karshi votuesve, por edhe për të përmbushur funksionet e tyre që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe drejtimin e brendshëm të forcës politike. Kështu sfidat e tyre përfshijnë:

- të arrijnë të ndërtojnë infrastrukturën e duhur për menaxhimin dhe komunikimin e brendshëm partiak,
- të zhvillojnë identitetin e qartë të forcës politike kundrejt partive të tjera politike dhe të projektojnë zgjidhje bindëse për problemet që ka vendi,
- të jenë në gjendje dhe të punojnë për të zgjeruar bazën e partisë me anëtarë, të trainojnë anëtarët dhe të sigurojnë sa më shumë të ardhura për të vënë në praktikë projektet e forcës së tyre politike.

Në thelb për të qenë e suksesshme një parti politike duhet të ketë:

- anëtarë me vullnet për të punuar
- drejtues informues dhe të përkushtuar
- ide të reja dhe praktike për të përmirësuar zhvillimin e vendit.

#### **Mbi të gjitha: Organizim të mirë!**

Por ndërkohë, nëse një parti nuk ka:

- procedura të mirëpërcaktuara të vendimarrjes
- nëse anëtarët nuk njohin, kuptojnë dhe ushtrojnë rolin dhe përgjegjësitë e tyre,
- nëse komunikimi në parti nuk arrihet,

atëherë: edhe një parti që ka anëtarë me vullnet për të punuar, drejtues të mirë, apo ide të reja, nuk do ti përmbush objektivat e saj.

## I. VLERA E PARTIVE POLITIKE

Parë në kënvështrimin e mbështetjes që sigurojnë në elektorat, në sistemin tonë politik egzistojnë si partitë e mëdha, ashtu edhe partitë e vogla. Çdo njëra prej tyre ka rolin, peshën dhe përgjegjësinë e saj në politikën shqiptare. Partitë e mëdha, janë të rëndësishme sepse kanë kapacitetin për të siguruar shumicën e mbështetjes së votuesve për të qeverisur vendin. Ndërkohë partitë e vogla kanë rëndësi në drejtim të (1) ndikimit që kanë për të ruajtur balancën e pushtetit në sistemin parlamentar, (2) mund të përcaktojnë se cila prej partive të mëdha (mbi baza koalicionesh) do të kontrollojë qeverinë dhe do të zgjedhë kryeministrin, (3) kanë rol njësoj si partitë e mëdha në përfaqësimin e zgjedhësve që i kanë votuar dhe jo vetëm të tyre.

## II. ÇFARË E BËN DEMOKRATIKE NJË PARTI POLITIKE?

Partitë Politike, si në pushtet ashtu dhe në opozitë, kanë për detyrë të mbështesin dhe mbrojnë vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut, së pari brenda organizimit të tyre. Niveli i demokracisë për një vend fillon tek niveli i demokracisë që kanë brenda vetvetes partitë politike.

### *Karakteristikat e demokracisë në një sistem demokratik:*

- Të gjithë janë të barabartë dhe të gjithë kanë të drejta individuale;
- Demokracia egziston kur shtetasit janë në gjendje të marrin pjesë aktivisht në jetën e shoqërisë duke ushtruar të drejtat e tyre.
- Qeverisja vjen nga populli dhe egziston për ti shërbyer atij.

### *Ndërkohë një parti ka **demokraci të brendëshme kur:***

- I lejon anëtarët e saj të shprehin lirshëm mendimet dhe opinionet e tyre,
- Nxit pjesëmarrjen në vendimarrje të të gjithë anëtarëve,
- është tolerante ndaj mendimit ndryshe,
- Respekton rregullat dhe procedurat e miratuara për vendimarrjet,
- Drejtohet nga drejtues që kanë besimin e anëtarëve dhe të mbështetësve të forcës politike,
- Nxit pjesëmarrjen e grave.

### *Kompromentojnë demokracinë e brendëshme praktika të tilla si:*

- mungesë komunikimi ndërmejt strukturave të niveleve të ndryshme të organizimit,
- mungesa e ndryshimit të drejtuesit të partisë,
- anëtarë partie pa rol në vendimarrje: partia drejtohet nga disa individë që nuk interesohen aspak për anëtarët.

### **III. STATUTI**

Është dokumenti bazë që përcakton parimet, rregullat e organizimit të brendshëm të një partie politike, strukturën, detyrat, rolin dhe funksionin e të gjitha njësive të saj. Për të garantuar koordinimin dhe koherencën e veprimit, në çdo nivel duhen përcaktuar qartë rolet, përgjegjësitë dhe autoriteti, gjë që e bën Statuti.

#### **Statuti përcakton kryesisht:**

- kriteret për të qenë anëtar i forcës politike,
- klasifikon pozicionet e drejtuesve dhe shpjegon metodat e përgjedhjes së tyre,
- përshkruan rolin dhe marrëdhënien mes njësive të ndryshme në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal,
- strukturën e organizimit të stafit të brendshëm teknik të forcës politike,
- përcakton komitetet ose komisionet në fusha të rëndësishme si politika zhvillimi, financë, etj.
- procedurat për zgjedhjen e njësive të ndryshme drejtuese të forcës politike dhe padyshim edhe të zgjedhjes së kryetarit të saj. Parti të ndryshme aplikojnë mënyra të ndryshme të zgjedhjeve brenda forcës politike, konkretisht zgjedhje e drejtpërdrejtë nga anëtarët ose jo e drejtpërdrejtë. Në rastin e zgjedhjes së kryetarit për shembull:
  - Jo e drejtpërdrejtë: Konventa, Kongrese kombëtare ku delegatë të zgjedhur nga anëtarët votojnë më pas për Kryetarin
  - E drejtpërdrejtë: të gjithë anëtarët votojnë për zgjedhjen e kryetarit (një anëtar një votë).

*E rëndësishme është të theksohet se statuti duhet të ketë rregulla që garantojnë përfshirjen e anëtarëve dhe besimin e tyre në të gjithë aktivitetin e brendshëm të partisë.*

#### **Disa nga funksionet dhe detyrat specifike:**

- Kryetari:
  - Menaxhon degën dhe programin
  - Propozon objektivat në lidhje me rritjen e numrit të anëtarëve, të ardhurat komunikimin etj.
  - Lehtëson punën në marrjen e vendimeve
  - Merr përgjegjësitë për suksesin politik dhe financiar të degës lokale
  - Njih dhe përdor aftësitë dhe eksperizën e anëtarëve.
  - Koordinon punën me partitë aleate në nivel lokal.
  
- Zëvendëskryetari:
  - Ndhmon dhe mbështet kryetarin

- E zëvendëson kryetarin kur është e nevojshme
- Drejton nënkomitete të vecanta
- Moniton aktivitetin politik në zonë

■ Sekretari:

- Merr masat për realizimin e mbledhjeve
- Mban shënimet gjatë mbledhjeve
- Raporton mbi shënimet e mbajtuara në mbledhjen paraardhëse
- Konsultohet me kryetarin për zhxhendën e mbledhjes
- Përgatit raportin apo materiale të tjera të mbledhjes
- Punon me financierin për përgatitjen e raportit financiar.
- Lajmëron pjesëmarrësit për kohën dhe axhendën e takimit
- Mban listat e anëtarësisë

■ Financieri:

- Harton buxhetin dhe kryen pagesat financiare
- Mban përgjegjësi për menaxhimin financiar të degës
- Koordinon mbledhjen e kuotave të anëtarësisë me sekretarin
- ndihmon në mbledhjen e fondeve për partinë.

- Funksione të tjera: komunikimi, studime, trainime, organizimi dhe rekrutimi i anëtarëve.

**Marrëdhëniet brenda partisë**

Një parti politike e suksesshme organizohet dhe menaxhohet njësoj si të ishte një organizëm tjetër publik apo privat. Në nivelin bazë partia duhet të ketë një skemë menaxhimi të qartë dhe një strukturë komunikimi që njihet dhe zbatohet nga të gjithë anëtarët. **Të gjithë**, që nga anëtari më i thjeshtë e deri tek drejtuesi kryesor **duhet të kenë të qartë rolin dhe përgjegjësitë e tyre**. Drejtuesit lokal duhet të kuptojnë pozicionin e partisë për çështje madhore dhe planet për të ardhmen. Të gjithë duhet të kenë mundësinë për të pyetur për të marrë përgjigje për pyetjet, për të shprehur lirshëm opinionin.

**Përmbledhtazi, drejtuesi dhe anëtarët duhet:**

- Të kenë role e detyra të mirëpërcaktuara e të qarta brenda partisë,
- Të kuptojnë misionin, objektivat dhe strategjitë e partisë.
- Të përdorin metoda për të informuar tek drejtuesi i partisë.
- Të kenë aftësinë të angazhojnë anëtarët në shkëmbimin e ideve dhe vendimarrjet.

***Komunikimi duhet të jetë i dyanshëm:***



*Nivel lokal*       $\longleftrightarrow$       *Nivel Kombëtar*

Drejtuesit lokal duhet të marrin nga drejtuesit kombëtar:

- Informacion mbi pozicionin zyrtar të partisë në lidhje me çështje madhore
- Këshillim se si të diskutojnë mbi çështje të vëshira dhe delikate
- Informacion koherent mbi aktivitetet politike dhe zhvillimet në parti, parlament dhe në vend.

***Marrëdhënia raportuese:***

- Që nga anëtari deri tek kryetari i partisë duhet të dijnë se kujt duhet ti raportojnë dhe se kush raporton tek ata.
- Krijimi dhe ruajtja e një zinxhiri komandimi dhe marrje vendimesh është metodologji që përdoret nga organizatat efektive (jo partiake).
- Ky zinxhir kërkon përshkrimin e punës për këdo të përfshirë në parti politike.

***Përshkrimi i punës:*** detajon fushën e përgjegjësisë dhe detyrat specifike.

*Shembull i Përshkrimit të Punës:*

“Sekretari për Organizimin e degës lokale: është përgjegjës për rekrutimin e anëtarëve të rinj, mbledhjen e informacionit dhe komunikimin e mesazhit të forcës politike. Sekretari për Organizimin i paraqet raportin me shkrim Sekretarit respektiv në nivelin e Rrethit në datën 2 dhe 17 të cdo muaji.....”

***Rrugët për të raportuar***

- buletine dhe materiale të tjera të përgatitura (për përdorim të brendshëm) si nga zyrat qendrore ashtu dhe nga degët lokale.
- Takime të rregullta mes drejtuesve partiak dhe drejtuesve lokal.
- Telefonata (kur mungojnë fondet për takime ballë për ballë).

## WORKSHOP 2

### PËRZGJEDHJA E KANDIDATËVE TË FORCËS POLITIKE PËR FUNKSIONE PUBLIKE

#### **Grupi A:**

Grupi juaj është ngarkuar për të shkruar pjesën e statutit që lidhet me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për deputet të forcës suaj politike. Diskutoni, vendosni dhe shkruani këtë procedurë.

#### **Grupi B:**

Grupi juaj është ngarkuar për të shkruar pjesën e statutit që lidhet me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar Bashkie të forcës suaj politike. Diskutoni, vendosni dhe shkruani këtë procedurë.

#### **Grupi C:**

Grupi juaj është ngarkuar për të shkruar pjesën e statutit që lidhet me procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për Kryetar të forcës suaj politike. Diskutoni, vendosni dhe shkruani këtë procedurë.

## IV. PLATFORMA POLITIKE

*Një parti politike mbështetet nga zgjedhësit kur dëshmon se interesohet për problemet e tyre dhe ndan me ta të njëjtat shqetësime dhe shpresa për të ardhmen dhe kur dëshmon se ka një projekt të qartë se si do të përmirësojë jetën e tyre.*

Hartimi i platformës politike mund të realizohet në rrugë të ndryshme:

- Nga një staf ekspertësh në nivelin qendror që inicojnë procesin e planifikimit dhe hartojnë draftin fillestar.
- Nga një grup miks: ekspertë, anëtarë partie, specialistë të paanshëm.
- Nga përfshirja e të gjithë anëtarëve të partisë përmes krijimit të rrjeteve të grupeve studimore, forumeve publike.

Pavarësisht se kush punon për të hartuar platformën politike e rëndësishme është se thelbi i punës qëndron **në njohjen reale të shqetësimeve të votuesve** dhe më pas **në gjetjen e alternativave** më të përshtatshme për ti zgjidhur këto probleme.

***Rrugët e identifikimit të problemeve dhe zgjidhjeve respektive:***

- Konferenca me frekuencë 2 herë në vit për të diskutuar çështje të paracaktuara:
  - p.sh çështjet e vendimarrjes lokale,
  - pjesëmarrja e grave dhe të rinjve në vendimarrje,
  - çështje të arsimit etj.
  - Sesione plenare dhe panele me tema specifike.
  - Pjesëmarrje e anëtarëve që kanë lidhje me çështjen dhe e ekspertëve të pavarur.
- Pyetësor për anëtarët dhe qytetarët për çështje specifike.
- Fokus grupe për çështje specifike
- Forume publike etj.

## V. KOMUNIKIMI

*Komunikimi nuk është asgjë tjetër veçse lëvizje e informacionit nga burimi tek audiencia. Çdo parti politike duhet të konceptojë një program sepcifik si për komunikimin e brendshëm të saj (pra drejtuesit me anëtarët dhe anasjelltas), ashtu dhe për komunikimin me publikun.*

**Komunikimi me anëtarët:**

Përpara se të mendosh se si të komunikosh me publikun mendo se si të komunikosh me anëtarët, pasi anëtarët janë një mënyrë për të shkuar tek publiku dhe si të tillë anëtarë të informuar-janë mundësia më e mirë komunikimi me publikun.

### **Hapat:**

- Planifiko dhe koordino programin vjetor të komunikimit në të gjitha nivelet: kombëtar, rajonal, rrethi, dhe bashki/komunë.
- Në secilin nivel cakto një person që do të drejtojë punën , p.sh sekretar për komunikimin dhe median.
- Sekretari duhet të ngrejë ekipin e tij (vullnetarë mundësisht) që e ndihmojnë për të zbatuar programin.
- Ekipi diskutoon dhe vendos programin e nivelit që mbulon.
- Programi përcakton rrugët e komunikimit, p.sh buletine informuese periodike për anëtarët etj.
- Ekipi koordinon punën me ekipe të tjera, p.sh me ata që punojnë për mbledhjen e fondeve, ekipin e organizimit etj.
- Sekretari për komunikimin merr pjesë në të gjitha takimet që zhvillohen me drejtuesit në nivelin respektiv me qëllim që të jetë i informuar:
  - mbi zhvillimet lokale të forcës politike
  - mbi informacionin që vjen nga anëtarët
  - mbi aktivitete të planifikuara nga dega lokale dhe rezultatet e tyre etj.

### **Komunikimi me publikun:**

*Gjithë aktiviteti i partive politike ka në qendër të vëmendjes çdo ditë, çdo orë: ZGJEDHËSIT dhe NEVOJAT e tyre!*

### **Teknikat:**

- ⇒ Komunikim i drejtpërdrejtë (takime të drejtpërdrejta me publikun)
- ⇒ Komunikim jo i drejtpërdrejtë
  - media
    - intervista
    - debate televizive
    - shkrime, artikuj në gazeta
    - konferenca shtypi

■ njoftime,deklarat për shtyp

⇒ aktivitetet e ndryshme publike të forcës politike

⇒ interneti (faqe në internet, e mail, sms)

⇒ publikime

buletine për publikun

libra etj

⇒ materiale me mesazhe për forcën politike

postera, fletëpalosje

## WORKSHOP 3

### KOMUNIKIMI I BRENDSHËM DHE MARRJA E VENDIMEVE DEMOKRATIKE

#### **Grupi A:**

Kryetari i degës suaj ka marrë në fund të vitit shpërblim nga fondet e degës suaj lokale, pas pasur një vendim të kryesisë (pra tuajin) për këtë qëllim. Gjatë analizës së buxhetit të vitit të sapo mbyllur financiar, njërit prej anëtarëve të kryesisë i ka rënë në sy ky fakt dhe ka kërkuar urgjentish mbledhjen e kryesisë.

Ju jeni mbledhur për të diskutuar për këtë çështje.

**Roli 1:** Ju jeni kryetari i partisë. Nuk merrni rrogë nga partia, por mendoni se të paktën një shpërblim në fund të vitit ju takon.

**Roli 2:** Ju jeni financieri i degës lokale. Nuk keni patur vendim të shkruar për ti bërë pagesën e honorarit kryetarit, por e keni paguar pasi mendoni që ai është kryetar dhe në të kundërt ju heq nga puna.

**Roli 3:** Ju jeni anëtari i kryesisë që keni kuptuar shkeljen e statutit për rastin konkret dhe keni kërkuar thirrjen urgjente të mbledhjes. Jepni argumentat për shkeljen e bërë dhe bëni propozimin tuaj për vendimin që duhet të marrë kryesia për këtë rast.

**Roli 4:** Ju jeni anëtar i kryesisë dhe jeni thirrur në mbledhje urgjente për të diskutuar shkeljen e bërë nga kryetari. Merrni pjesë aktivisht në mbledhje dhe jepni mendimin tuaj se çfarë vendimi duhet marrë.

### **Grupi B:**

Sekretari organizativ i degës suaj lokale ka marrë një letër nga njëra prej organizatave e cila ankohet që drejtuesit lokal kujtohen për anëtarët vetëm kur ka fushata dhe mitingje. Edhe kur anëtarët e organizatës mblidhen e diskutojnë për mbledhje ata informojnë rregullisht me shkrim për opinionet e shprehura Sekretarin Organizativ të partisë në nivelin lokal, por prej tij nuk kanë marrë asnjëherë përgjigje. Këtë rradhë organizata ia ka drejtuar letrën kryetarit të kryesisë lokale i cili ka thirrur urgjentisht mbledhjen e kryesisë.

**Roli 1:** Ju jeni kryetari i kryesisë dhe jeni i shqetësuar për dy fakte: 1. sekretari organizativ nuk ka vlerësuar shqetësimin e anëtarëve të shprehur në disa letra, për të cilat kryesia nuk është vënë në dijeni. 2. faktin që anëtarët ndihen të lënë mënjanë.

**Roli 2:** Ju jeni sekretari organizativ dhe i shpjegoni kryesisë se duke qenë punë vullnetare nuk keni kohën e mjaftueshme për tu marrë edhe me letra organizatash.

**Roli 3:** Ju jeni anëtarë dhe duhet të jepni mendimin tuaj për dy çështje:

1. si do të veprohet me sekretarin organizativ?
2. çfarë duhet të bëjë kryesia për të dëgjuar më shumë anëtarët?

## **VI. GJETJA E FONDEVE**

*Paratë nuk janë asnjëherë të mjaftueshme për të përmbushur detyrat, funksionet dhe projektet e partive politike. Fondet publike për partitë politike lidhen me fushatat elektorale dhe pas tyre sipas përqindjes së përfaqësimit në parlament.*

⇒ Sipas praktikave të financimit publik të partive politike në disa vende, burimet financiare të partive (përveç anëtarëve të saj) vijnë nga:

- fonde qeveritare për shpenzime të fushatave elektorale
- grante vjetore për të financuar aktivitetin e partive
- hapësira pa pagesë në media gjatë fushatave
- grante për organizatat bashkëpunuese me partitë politike, të tilla si institute studimore dhe edukuese
- heqje e taksave për kontributet.

Në nivel kombëtar duhet të egzistojë funksioni i Drejtuesit të Financave të Partisë.

⇒ Përgjegjësitë e tij:

- zhvillimi i strategjive për sigurimin e të ardhurave për forcën politike.
- Koordinimi i aktivitetit me nivelet e tjera të organizimit të partisë.
- Siguron të ardhurat ndërsa financieri i administron ato.

**Drejtuesi i financave të partisë duhet të përgatisë Strategjinë e Sigurimit të Fondeve, që në thelb përmbledh:**

⇒ Cili është objektivi?

⇒ Ku do të gjenden fondet?

⇒ Sa do të kushtojnë aktivitetet që do të organizohen për mbledhjen e fondeve?

⇒ Si do të administrohen fondet?

**Teknika tipike të fund-raising:**

⇒ **Kërkesa e drejtëpërdrejtë**

- Identifiko personin që ka mundësi për të dhënë fonde
- Kontaktoje drejtëpërdrejt dhe kërko mbështetjen e tij

⇒ **Krijimi i Komitetit të Sigurimit të Fondeve**

- Përbëhet nga një numër individësh që kanë rreth të gjerë njohjesh dhe që ndihmojnë në mbledhjen e fondeve, duke iu drejtuar:
  - Të afërmve
  - Shokëve, miqve
  - Bizneseve

⇒ **Organizim i evenimenteve për mbledhje fondesh. KUJDES KOSTON!**

- pritje ose darka zyrtare
- aktivitete muzikore
- aktivitete në ambiente të hapura, piknik

⇒ **Dërgim letrash tek mbështetësit**

- Ndërto listën e personave që u dërgosh letrën
- Harto tekstin
- Kush do ta firmosë?



⇒ **Telefonata për mbështetësit:**

- Traino telefonuesit
- Përgatit tekstin
- Monitoro telefonatat
- Krijë listën e telefonuesve që të mbështetën

## **WORKSHOP 4**

### **FUND RAISING**

#### **Grupi A:**

Ju jeni anëtar i Njësisë Drejtuese të **Forumit Rinor** të njëjës prej Bashkive kryesore në vend. Pas diskutimeve të ditës së djeshme keni hartuar projektin e Forumit tuaj lokal për vitin e ardhshëm. Por dje diskutuat vetëm për shpenzimet. **Si do ti siguroni të ardhurat?**

Hartoni projektin tuaj për të siguruar të ardhurat.

#### **Grupi B:**

Ju jeni anëtare e Njësisë Drejtuese të **Forumit të Gruas** të njëjës prej Bashkive kryesore në vend. Pas diskutimeve të ditës së djeshme keni hartuar projektin e Forumit tuaj lokal për vitin e ardhshëm. Por dje diskutuat vetëm për shpenzimet. **Si do ti siguroni të ardhurat?**

Hartoni projektin tuaj për të siguruar të ardhurat.

## **PJESA E TRETË:**

### **FUSHATA ELEKTORALE**

#### **HYRJE**

Zgjedhjet shërbejnë për të përzgjedhur mes politikave që ofrojnë parti të ndryshme politike më të mirën dhe për të përzgjedhur mes politikanëve ata që do të jenë vendimarrës. Partitë politike ose kandidatët gjatë fushatave elektorale propozojnë politika specifike dhe shpjegojnë se si këto politika do të ndikojnë në mirëqenien e shtetasve; votuesit vendosin se cilat prej këtyre propozimeve ata duan që të zbatohen dhe se cilët politikanë do të ngarkohen me zbatimin e tyre.

Nga ana tjetër zgjedhjet shërbejnë për ti bërë politikanët të përgjegjshëm për veprimet që ata kryejnë apo vendimet që marrin, sepse ata e dinë që pas një harku kohor zgjedhjet vijnë sërish dhe ata do të rivlerësohen jo thjesht për zgjidhjet e reja që do tu ofrojnë zgjedhësve, por edhe për mënyrën se si kanë punuar gjatë mandatit të mëparshëm (kjo vlen si për shumicën në parlament që qeveris vendin, ashtu dhe për opozitën, që ndikon në vendimarrje përmes parlamentit).

Në këtë pjesë të Manualit ne do të ndalemi në dy elementë kryesorë: (1) roli dhe rëndësia e fushatave elektorale dhe (2) fazat e realizimit të fushatave elektorale. Informacioni në lidhje me fazat e realizimit të fushatave elektorale do të përqëndrohet jo thjesht në teknikat bazë të fushatës, por në mënyrë të veçantë tek ata elementë të saj ku ju mund të angazhoheni më aktivisht.

#### **I. ROLI DHE RËNDËSIA E FUSHATAVE ELEKTORALE**

Demokracia si një tërësi të drejtash bazë dhe procedurash, është një parakusht për garë politike dhe elektorale. Në fakt ka një lidhje të ngushtë mes konkurrencës (garës) dhe demokracisë. Demokracia është përkufizuar edhe si “qeverisje me miratimin e popullit” dhe sistemi demokratik shihet si një tërësi rregullash të ndërtruara për të ushtruar zgjedhje konkurruese të lira, të ndershme dhe të ligjshme. Metoda demokratike është i vetmi instrument për të arritur tek vendimarrjet politike mbi bazën e të cilave individë të veçantë arrijnë të marrin pushtet përmes konkurimit që ka si objekt votën popullore.

Fushatat elektorale janë periudha më e rëndësishme e aktivitetit të një force politike. Objektivi kryesor i partive politike është qeverisja e vendit, objektivi që e

ka zanafillën e tij tek fushata elektorale. Në përputhje me sistemin elektoral partitë politike paraqesin kandidatët e tyre, që përmes votës popullore mandatohen prej tij për ta përfaqësuar në parlament. Siç edhe e shpjeguar në pjesën e parë të këtij Manuali partia që fiton shumicën e vendeve në parlament, pra që ka numrin më të madh të deputetëve, ka edhe mundësinë për të krijuar kabinetin qeveritar e vetme (kur numri i vendeve që ka fituar e lejon të qeverisë e vetme) ose në koalicion me parti të tjera parlamentare.

Paraqitja e kandidatëve për anëtarë të parlamentit dhe përgatitjes së politikanëve për kabinetet qeveritare janë dy drejtimet kryesore të funksionit të partive politike. Është e qartë që secila prej tyre është e lidhur drejtpërdrejtë me një nga elementët përbërës e të rëndësishëm të sistemit politik: sistemit elektoral, pra garës elektorale.

Synimi i partive është të maksimalizojnë pushtetin e tyre dhe ky pushtet maksimalizohet vetëm përmes votës të zgjedhësve. Gara mes partive politike për të arritur të njëjtin objektiv prodhon një rezultat që shkon në favor të një pale të tretë: elektoratit. Konkurenca është një mekanizëm përmes të cilit partitë politike që janë të përfshira në përpjekjen për votën e popullit, janë të detyruar të mbajnë parasysh preferencën e elektoratit për një politikë të caktuar në krahasim me një tjetër. Në këtë rast vlera që merret nga konkurimi është përgjegjshmëria.

Por fushatat elektorale janë po aq të rëndësishme edhe për zgjedhësit. Në kushtet e demokracisë përfaqësuese përfshirja e tyre në procesin e përzgjedhjes mes kandidatëve të ndryshëm të forcave të ndryshme politike, apo alternativave të ndryshme që prezantojnë partitë politike, është në vetvete përfshirje në vendimarrje të rëndësishme. Periudha e fushatave elektorale e bën diskutimin mbi rrugëzgjdhjet e ndryshme që ofrojnë partitë politike për problemet që na shqetësojnë të gjithëve si zgjedhës, shumë më real dhe më të dukshëm për të gjithë. Përmes votës së tyre zgjedhësit shprehen se “kush” duan ti qeveris (preferenca për partitë politike) dhe se “si” duan të qeverisen (preferenca për programin politik-alternativën qeverisëse).

## **II. KONCEPTIMI I FUSHATAVE ELEKTORALE**

Fushatat elektorale kalojnë përmes tre fazave kryesore:

1. Përgatitja e strategjisë së fushatës
2. Planifikimi i fushatës
3. Realizimi konkret i saj (aktivitetet e fushatës).

Secila prej tre fazave zhvillohet në periudha kohore të ndryshme që në fakt pasojnë njëra-tjetrën. Elementi “kohë” është një ndër elementët më të rëndësishëm të fushatës elektorale.

Si rregull procedurat ligjore parashikojnë periudhën zyrtare të fushatës elektorale, që shpesh varion nga 30-40 ditë përpara ditës së caktuar të zgjedhjeve. Por ky interval në thelb i përgjigjet fazës së tretë të fushatës elektorale: realizimit të aktiviteteve të planifikuara të fushatës.

Dy fazat pararendëse, strategjia e fushatës dhe planifikimi i saj nga pikpamja kohore ndodhin shumë kohë përpara fillimit zyrtar të fushatës elektorale (fazës së tretë).

Në fakt ekspertët e fushatave elektorale sygjerojnë që përgatitjet për fushatën elektorale të rradhës të fillojnë menjëherë pas përfundimit të fushatës paraardhëse. Kjo në thelb nënkupton që strukturat partiake vazhdimisht punojnë për të ruajtur komunikimin me zgjedhësit, mbi të gjitha me ata që konsiderohen si të lëkundur, apo abstenues (nuk marrin pjesë në votim).

## **II.1. STRATEGJIA E FUSHATËS**

Ka një numër komponentësh që e bëjnë të suksesshme një fushatë elektorale, pjesa dërmuese e të cilave përfshihen në strategjinë e fushatës. Strategjia e fushatës është në vetvete analizë e detajuar e një numri çështjesh, njohja e mirë e të cilave ndihmon në planifikimin dhe realizimin e një fushate të suksesshme.

**Hartimi i strategjisë duhet të kalojë në disa hapa:**

### **Hapi i Parë: Njohja e Zonës Elektorale**

Siç edhe kuptohet lehtë analiza në këtë drejtim synon të japë një profil social-ekonomik, demografik, gjeografik të zonës. Konkretisht:

#### ***a. Njohja gjeografike:***

- ⇒ Njohja e zonës në terren, veçanërisht kufijve të saj.
- ⇒ Sigurimi i hartës elektorale në tërësi dhe hartave të të gjitha qendrave të votimit.

#### ***b. Të dhënat demografike të zonës:***

- ⇒ Numri i banorëve
- ⇒ Kategoritë sociale (sa të punësuar, sa të papunë etj...)
- ⇒ Grupmoshat ( sa të rinj, sa mosha mesatare, sa të moshuar etj)

### ***c. Zhvillimi ekonomik-social i zonës***

- ⇒ Numri, natyra e bizneseve në zonë
- ⇒ Organizata joqeveritare apo projekte që po realizohen në zonë

### ***d. Njohja e problemeve të zonës:***

- ⇒ Probleme ekonomike
- ⇒ Probleme sociale-kulturore
- ⇒ Probleme infrastrukturore etj.

### **Hapi i Dytë: Platforma e Partisë Politike**

Çdo parti politike në prag të zgjedhjeve përgatit një platformë bazë në të cilën kandidatët referohen për një sërë çështjesh, psh. Legalizimi, mirëqenia sociale, etj, etj. Përmes platformës politike jepen alternativat e zgjidhjes së problemeve të identifikuar në hapin e parë, si probleme më kryesore të zonës respektive.

### **Hapi i Tretë: Tendencat e Votuesve**

Partitë politike krijojnë një rekord specifik mbi rezultatet e zgjedhjeve në çdo zonë zgjedhore, si dhe në çdo qendër votimi. Rezultatet në çdo qendër votimi të zonës elektorale ndihmojnë për të identifikuar qendrat e votimit me rezultatin më të mirë për forcën politike, qendrat e votimit ku rezultati është gjithnjë humbës, si dhe qendrat ku rezultati ndryshon nga një zgjedhje në një tjetër. Kjo lloj analize ndihmon për të identifikuar qendrat e votimit prioritare ku do të përqëndrohet dhe pjesa kryesore e fushatës (pra targetim, por pa lënë në harresë gjatë fushatës edhe qendrat e tjera).

### **Hapi i Katërt: Njohja e Kundërshtarëve**

Analiza në këtë fazë konsiston në njohjen e pikave të dobëta dhe të forta të kundërshtarëve politik. Kjo për ti paraprirë “sulmeve” të tyre gjatë fushatës elektorale, por edhe për të ndërtuar strategjinë se si do ti “sulmojmë” për të bindur votuesit e lëkundur se alternativën më të mirë e ofron forca jonë politike dhe jo kundërshtarët tanë.

### **Hapi i Pestë: Formulimi i Mesazhit**

Rregullat kryesore të formulimit të mesazhit:

- ⇒ I shkurtër (një fjali)
- ⇒ I kuptueshëm (votuesit kanë nivele të ndryshme arsimore, apo të njohjes së çështjeve)
- ⇒ i veçantë (votuesit duhet të identifikojnë vetëm forcën tonë politike përmes mesazhit)

- ⇒ Optimist (duhet ti japi votuesve shpresën se me ne kanë më shumë garanci për përmirësim)
- ⇒ I vërtetë (në të kundërt votuesi humb besimin tek ne)

### **Hapi i gjashtë: Imazhi i Fushatës**

Në këtë fazë të fushatës analizohet gjithashka që duhet të realizojmë në drejtim të imazhit të fushatës. Konkretisht vendosim se:

- ⇒ Në ç'formë dhe në ç'mënyra do ta bëjmë fushatën të dukshme, të prekshme dhe përfshirëse për votuesit në zonën respektive.
- ⇒ Në ç'mënyrë do të dërgojmë mesazhin tek votuesit dhe do ti bëjmë ata të dëgjojnë, lexojnë, kuptojnë dhe mbështesin atë mesazh.

### ***Disa nga mënyrat më të përdorura janë:***

- ⇒ Fletëpalosje
- ⇒ Fletëvolante
- ⇒ Gazeta, buletine
- ⇒ Poster i lëvizshëm
- ⇒ Spotet televizive
- ⇒ Poster
- ⇒ Banderolat
- ⇒ Letrat për zgjedhësit

### **Hapi i shtatë: Strategjia e Komunikimit me Votuesit**

Në përputhje me karakteristikat e zonës dhe “shijet” e votuesve që kemi identifikuar tashmë, përcaktojmë teknikat e komunikimit me votuesit.

### ***Teknikat kryesore të komunikimit me votuesit:***

- ⇒ Takimet Publike (masive)
- ⇒ Takimet me grupe interesi, apo kategori sociale
- ⇒ Takimet e shtëpisë
- ⇒ Fushata derë më derë
- ⇒ Telefonatat

### **Hapi i tetë: Strategjia e Komunikimit me Median**

Media është një ndër mjetet më të fuqishme që e bën fushatën të dukshme dhe mbi të gjitha për të përcjellë mesazhet tek votuesit. Disa nga teknikat që duhen përdorur:

- ⇒ Njoftimet/deklaratat për shtyp
- ⇒ Konferencat e shtypit
- ⇒ Intervistat në gazeta, radio,televizione
- ⇒ Realizimi i evenimenteve me prezencën e medias

⇒ Debatet televizive

## II.2. PLANIFIKIMI I FUSHATES.

Hartohet fill pas përgatitjes së strategjisë së fushatës dhe përmbledh të gjitha aktivitetet e identifikuara gjatë analizës për hartimin e strategjisë. Për çdo aktivitet të planifikuar për tu realizuar gjatë fushatës është e rëndësishme që të shoqërohet me: Kohën **kur** do të realizohet, vendi **ku** do të realizohet, **kush** do të jetë/jenë personat përgjegjës për realizimin e tij, **buxheti** i nevojshëm për ta realizuar atë aktivitet.

Përmbledhtazi mund të shprehen përmes tabelës së mëposhtme:

### Plani i veprimit

Veprimi/aktiviteti	Përgjegjësi	Kohëzgjatja	Dita e fillimit	Vendi ku do të realizohet	Buxheti

Tabela do të jepte në mënyrë të detajuar të gjitha aktivitetet e parashikuara për tu realizuar në fazën e tretë dhe kjo bën që përpara fillimit zyrtar të fushatës elektorale ne të dimë se çfarë detyre do të kryejmë në secilën ditë dhe orë të periudhës zyrtare të fushatës.

### Drejtimi i Fushatës

Në përputhje me sistemin elektorale ndërtohet edhe skema respektive e organizimit elektorale. Në rastin e sistemit proporcional rajonal, siç u përshkrua në pjesën e parë, vendi ndahet me rajone ku në secilin rajon çdo parti politike konkuron me një listë kandidatësh. Rajoni specifikohet në Kodin zgjedhor dhe organizimi elektorale respekton këtë kriter.

### ***Drejtimi i fushatës në parim realizohet në disa nivele:***

- ❖ Niveli qëndror (kombëtar)
- ❖ Niveli rajonal (nëse rajoni në kod i referohet qarkut, atëherë kjo nënkupton edhe organizimin elektoral rajonal)
- ❖ Niveli lokal (Bashkia/Komuna)
- ❖ Niveli i Qendrës së Votimit

Në fakt të tre nivelet e para pikësynimin e kanë tek qendra e votimit, sepse pikërisht tek qendra e votimit ndodhen ata që përcaktojnë me votën e tyre fatin e zgjedhjeve. Tre nivelet e para kanë më shumë funksione drejtimi, menaxhimi, koordinimi, organizimi. Ato janë përgjegjëse edhe për hartimin e strategjisë së fushatës dhe planifikimin e saj dhe më pas koordinimin e të gjithë planit të fushatës ndërmjet niveleve të ndryshme të organizimit elektoral. Shumica e aktiviteteve të planifikuara të fushatës zhvillohen mbi bazën e qendrave të votimit.

## **II.3. REALIZIMI I FUSHATËS**

Në këtë pjesë do të ndalemi tek teknikat kryesore që përdoren gjatë fushatës elektorale për të siguruar mbështetjen e votuesve ndaj forcës sonë politike.

### **2.3.1. TEKNIKA TË IMAZHIT TË FUSHATËS**

#### **Fletëpalosje**

##### **Përse janë të nevojshme fletëpalosjet?**

- ⇒ Ndhmojnë në përhapjen e mesazhit
- ⇒ Informojnë zgjedhësit mbi alternativën e forcës sonë politike dhe zgjidhjet që ofrojnë për problemet e tyre.
- ⇒ Ruan kontaktin me votuesit: është e pamundur dhe ndërkohë e pakëshillueshme që votuesit ti trokasësh në derë (fushata derë më derë) më shumë se një herë gjatë fushatës. Këtë e bëjnë shumë mirë fletëpalosja.
- ⇒ Elementë informues që lidhen me procedurat e votimit, ditën e votimit etj.

#### **Gazeta, buletine**

- ⇒ Ana pozitive e gazetës është që informon më në detaje mbi fushatën.
- ⇒ Gazeta duhet të përmbajë lajme.

#### **Letrat**



- ⇒ Nuk janë të kushtueshme (printim, fotokopjim, shpërndarje)
- ⇒ Përdoren kryesisht si një mesazh i drejtpërdrejt i kandidatit/forcës politike drejtuar zgjedhësve. Më efektiv kur i drejtohen grupeve të targetuara: psh. Grave, të rinjve.
- ⇒ Letra duhet të formulohet me gjuhë të thjeshtë, e sinqertë, e drejtpërdrejtë. Qartazi kërkon mbështetjen e grave/të rinjve/... mbi bazën e disa arsyeve që janë të prekshme për kategorinë specifike ku adresohet.

### **Posteri**

- ⇒ Përmban një mesazh specifik që forca politike synon t'ua transmetojë zgjedhësve. Forca politike shpesh identifikohet përmes atij mesazhi.
- ⇒ E bën fushatën të dukshme dhe prezencën e forcës politike pranë zgjedhësve të kurdondodhëshme.

### **Poster i lëvizshëm**

- ⇒ Është i kushtueshëm sepse përveç përgatitjes dhe veshjes së një automjeti i shtohet kostoja e karburantit.
- ⇒ E mira është që ruan kontaktin viziv të fushatës me votuesit.
- ⇒ Ndihmon në fiksimin e mesazhit dhe subjektit politik.

### **Spotet televizive**

- ⇒ Shumë të kushtueshme si në përgatitje, por edhe në transmetim radio-televiziv.
- ⇒ Mesazhi është më i drejtpërdrejtë ndaj votuesit.
- ⇒ Mund të jenë spote që të kenë si elementë të tyre edhe kundërfushatën ndaj kundërshtarit/kundërshtarëve kryesore. Por kundërfushata duhet të përcaktohet në funksion të “shijeve” të votuesve në këtë drejtim.

### **Banderolat**

- ⇒ Nuk janë të kushtueshme
- ⇒ Vendosen në hapësira ku nuk dëmtohen lehtë
- ⇒ Nuk krijojnë konflikte me votuesit.

## WORKSHOP 5

### KONFERENCA E SHTYPIT

#### **Grupi A:**

Jeni 2 javë përpara ditës së zgjedhjeve të përgjithshme që do të zhvillohen për Kuvendin e Shqipërisë. **Gallup International ka publikuar rezultatet e një sondazhi që nxjerr fituese forcën tuaj politike.**

**Përgatisini dhe realizoni konferencën për shtyp mbi këtë çështje.**

#### **Grupi B:**

Jeni 2 javë përpara ditës së zgjedhjeve të përgjithshme që do të zhvillohen për Kuvendin e Shqipërisë. Partia juaj ka qenë në opozitë për katër vjet dhe synon mazhorancën në Kuvend. Por, **listat e zgjedhësve kanë një mori problemesh**, të cilat, sipas aktivistëve tuaj, rrezikojnë t'ju çojnë në humbje. Edhe pse keni dërguar një numër protestash në institucionet përkatëse asgjë nuk ka ndryshuar.

**Përgatisini dhe realizoni konferencën për shtyp mbi këtë çështje.**

### 2.3.2. KONTAKTET ME VOTUESIT

#### **Takimet Publike Masive**

- ⇒ E bëjnë fushatën shumë më të dukshme.
- ⇒ Rrisin entuziazmin e fushatës.
- ⇒ Dëshmojnë mbështetjen që ka forca politike nga votuesit e zonës.
- ⇒ Bën publik prioritetet dhe angazhimet politike të forcës politike.
- ⇒ Mundësi për të atakuar publikisht kundërshtarin/kundërshtarët.

#### **Takimet e shtëpisë**

Çfarë është një takim në shtëpi? Është një grumbullim njerëzish në një shtëpi për të diskutuar çështjet e zgjedhjeve. Pjesëmarrës mund të jenë miq të të zotit

të shtëpisë (banorë të zonës), ose mund të jetojnë në të njëjtën rrugë ose mund ti përkasin të njëjtit grup, psh nxënës të vitit të katërt të shkollës së mesme.

### ***Si të organizojmë takimet e shtëpisë?***

1. Gjeni një person pritës. Mund të jetë një anëtar, mbështetës që dëshiron që takimi të zhvillohet në shtëpinë e tij/saj.
2. Vendosni një datë dhe orë të përshtatëshme.
3. Ftoni njerëzit në takim më shumë njerëz se sa mendoni se do të vijnë. Numër i mirë për takimet e shtëpisë është rreth 20 njerëz.
4. Caktoni një axhendë për takimin. Caktoni kohë të mjaftueshme për diskutime. Takimet nuk duhet të zgjasin asnjëherë mbi 2 orë.
5. Rregulloni ambientin ku do të zhvillohet takimi (karriget, kafe, pije freskuese)

### **Fushata derë më derë**

Është një nga teknikat e fushatës që konsiderohet si më e efektshmja në drejtim të kontaktit të drejtpërdrejtë me votuesit.

Në fakt jep vërtet rezultat sidomos kur bëhet fjalë për parti politike që janë shumë mirë të organizuar në territorin e një zonë zgjedhore dhe me struktura që punojnë në mënyrë konstante, pra jo vetëm në periudhë zgjedhore.

Kjo gjë të ndihmon për të identifikuar :

- ⇒ votuesit e sigurtë për partinë
- ⇒ të lëkundurit
- ⇒ kundërshtarët

Energjitë më të mëdha në fushatë duhet të shpenzohen me të lëkundurit.

### **Regulla për fushatën derë më derë:**

- ⇒ Njihni shumë mirë zonën dhe problemet e saj.
- ⇒ Kërkoni të flisni me të gjithë votuesit në shtëpi (jo të gjithë votojnë njësoj)
- ⇒ Pajisuni paraprakisht me materiale informuese.
- ⇒ Shkoni në orë të përshtatëshme
- ⇒ Vishuni në mënyrë të rregullt dhe sa më pranë natyrës së zonës ku kandidoni.
- ⇒ Punoni në dyshe
- ⇒ Asnjëherë mos pini më parë.
- ⇒ Mos pini duhan apo përtypeni gjatë takimit.
- ⇒ Jini miqësor
- ⇒ Mos e humbni gjakftohtësinë
- ⇒ Flisni thjeshtë dhe qartë.

- ⇒ Jini i hapur dhe pranoni kritikant
- ⇒ Tolerant dhe informues.
- ⇒ Përgjigjuni gjithmonë pyetjeve që ju bëhen.

### **Telefonatat**

Janë një nga teknikat që përdoret gjatë fushatve elektorale. Ka tipe të ndryshme telefonatash:

- ⇒ telefonata që shërbejnë për identifikimin e mënyrës se si votojnë zgjedhësit (sondazh telefonik)
- ⇒ telefonata për të informuar zgjedhësit mbi takime që zhvillohen gjatë fushatës
- ⇒ telefonata që nxisin pjesëmarrjen e zgjedhësve ditën e zgjedhjeve në votime.

## **WORKSHOP 6**

### **AXHENDA POLITIKE DHE MESAZHI**

#### **Grupi A:**

Ju jeni stafi i njërit prej **Kandidatëve për Kryetar të Partisë** suaj. Detyra juaj është të përgatisni **mesazhin qëndror të Kandidatit** tuaj drejtuar anëtarëve të partisë, dhe më pas **një poster** që ai do ta përdorë gjatë fushatës një mujore që do të zhvillojë për të siguruar mbështetjen e anëtarëve.

#### **Grupi B:**

Ju jeni stafi i **Kandidatit për Deputet të Partisë** suaj në një prej Bashkive kryesore në vend. Detyra juaj është të përgatisni **mesazhin qëndror të Kandidatit** tuaj drejtuar zgjedhësve, dhe më pas **një poster** që ai do ta përdorë gjatë fushatës që do të zhvillojë për të siguruar mbështetjen e zgjedhësve.

### **Grupi C:**

Ju jeni stafi i **Kandidatit për Kryetar Bashkie** të Partisë suaj në një prej Bashkive kryesore në vend. Detyra juaj është të përgatisni **mesazhin qëndror** të Kandidatit tuaj drejtuar zgjedhësve, dhe më pas **një poster** që ai do ta përdorë gjatë fushatës që do të zhvillojë për të siguruar mbështetjen e zgjedhësve.

### **2.3.3 DITA E ZGJEDHJEVE**

Ka një numër veprimesh që kryhen ditën e zgjedhjeve, por që në thelb synojnë:

- ⇒ të garantojnë një proces demokratik dhe normal votimi
- ⇒ të frenojë çdo përpjekje për të manipuluar votat
- ⇒ të sigurojë pjesëmarrjen në votim të të gjithë mbështetësve të identifikuar gjatë fushatës si votues të forcës sonë politike.
- ⇒ Të monitorojë procesin e numërimit të votave dhe të mbrojnë rezultatin e arritur.

### **Veprimet kryesore gjatë ditës së zgjedhjeve:**

- ⇒ Paraqitja e komisionerëve në qendrat e votimit.
- ⇒ Vëzhguesit evidentojnë dhe raportojnë problemet.
- ⇒ Evidentimi i parregullsive dhe ankime të mundshme pranë KQZ.
- ⇒ Deklarata për shtyp ose konferenca për shtyp, për të informuar opinionin publik mbi procesin e votimit.
- ⇒ Kujdesi për komisionerët. Komisionerët qëndrojnë në qendrën e votimit gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve. Atyre si rregull u dërgohet ushqimi dhe pijet freskuese në qendrën e votimit për të garantuar që ata e ndjekin pa ndërpreje procesin.
- ⇒ Proçesi i numërimit të votave.
- ⇒ Ruajtja e entuziazmit për fitoren deri në sekondën e fundit. Është një element shumë i rëndësishëm që shpesh ndikon edhe në mbrojtjen e votës.